



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:088546

Datë: 03.02.2020

Numri i dokumentit: 00840224

C.nr.999/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit A.M nga fshati ...-Komuna Ferizajt, kundër të paditurve N.S, G.S nga Ferizaj, Rr. ..., A.S ish nga Ferizaj, tani me adresë të pa njohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.I.Q, B.S, D.S nga Ferizaj Rr....., H.A nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim av.F.R, nga Ferizaj, Z.B, A.B dhe I.B që të tre nga Suhareka, Rr....., me objekti kontesti vërtetimin i të drejtës së pronësisë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 22.01.2020, mori, kurse me datën 03.02.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.M nga fshati ... Komuna Ferizajt, **si e bazuar.**
- II. VËRTETOHET** se paditësi A.M është pronar i NK.nr.... në sipërfaqe prej 12469 m² me kulturë arë e klasit të 5-të, e cila gjendet në vendin e quajtur “K.Z” Zona Kadastrale
- III. DETYROHEN** të paditurit N.S, G.S, A.S, B.S, D.S, H.A, Z.B, A.B dhe I.B si trashëgimtar të ndjerit S.S që t’ia njohin paditësit të drejtën e pronësisë në paluajshmërinë e përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë së tij, do t’i shërbej paditësit, për bartjen e pronësisë të pjesës së vetë ideale në emrin e vet, pranë Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Ferizajt.

IV. DETYROHET paditësit që përfaqësuesit të përkohshëm t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 509€.

A r s y e t i m

Paditësi në fjalën e tij ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se nga provat e administruara u vërtetua baza juridikë e kërkesëpadisë, pasi që nga deklarata e të paditurve N... dhe G.S të cilët kanë prezantuar në seancën përgatitore, nuk e kanë kontestuar kërkesëpadinë, pasi që të njëjtit e kanë pohuar pretendimet se ka ekzistuar marrëveshja e shitblerjes të paluajtshmërisë në mes të ndjerit S.S si shitës i cili ka qenë trashëgimlënësi i të paditurve dhe S.M si blerës tani i ndjeri i cili ka qenë prindi i paditësit e cila shitblerje ka ndodhur në vitin 1960, në të cilën periudhë është përmbushur edhe çmimi kontraktues dhe që nga ajo kohë, kemi hyrë në posedim dhe shfrytëzim të ligjshëm dhe me mirëbesim.

Njëherit ka shtuar se arsyeja e mos bartjes së kësaj prone në emrin e prindit tij ka qenë fillimisht që me kohë nuk i kanë bërë bartjet për shkak të neglizhencës kurse pas vdekjes së të ndjerit S.S ka ndodhur për faktin se trashëgimtarët e tij nuk kanë pasur mundësi ti rregullojnë dokumentacioni e nevojshëm për të ndjerin S.S, pasi që disa trashëgimtar jetojnë edhe jashtë vendit me adresë të panjohur siç është e paditura A.S, i cili fakt është vërtetuar dhe nga deklarata e të paditurit N.S për këto arsye nuk kanë mundur ta kryejnë trashëgiminë për pasurinë e paluajtshme të ndjerit S.S, që tek pastaj me anë të kontratës formale të shitblerjes do t'ia barteshin në emër të tij.

Andaj ka theksuar se përveç deklaratave të paditurve të cilët nuk e kanë mohuar kërkesëpadinë, sa i përket mirëbesimit dhe ligjshmërisë së posedimin, është vërtetuar edhe përmes dëgjimit të dëshmitarëve, duke kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar pasi pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 28 par.4 i LTHMJP-së me anë të parashkrimit fitues.

Gjykata në bazë të nenit. 423.4 të LPK- së, ka mbajtur seancën në mungesë të paditurve N.S, G.S, B.S, D.S, Z.B, A.B dhe I.B, pasi që të njëjtit sipas flet kthesave të ardhura, është konstatuar se ftesat i kanë pranuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk kanë prezantuar, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar.

I padituri N.S me anë të përgjigjes në padi dhe në seancën e datës 25.04.2019, ka deklaruar se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke shtuar se është e vërtetë se prindi i tij në vitin 1950-60, sipas marrëveshjes gojore ia ka shitur pronën në fjalë prindit të paditësit për të cilën shitblerje e ka pranuar edhe çmimin kontraktues në tërësi në emër të shitblerjes, dhe nga ajo kohë prindi i paditësit S.M dhe tani pas ardhësi i tij A.M këtë pronë e shfrytëzon në mënyrë të qet dhe të pa penguar nga askush.

I padituri G.S gjithashtu nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka përkrahur fjalën e të paditurit N.S

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës A.S, av.I.Q, në fjalën e tij ka deklaruar se mbesim edhe më tutje pranë përgjigjes në padi, thëniet e cekura në seancat e kaluara, duke shtuar se nga provat e administruara, dëgjimit të dëshmitarëve, është vërtetuar fakti se paraardhësi i paditësit, e ka blerë pronën kontestuese, nga paraardhësi i të paditurës, andaj në rastin konkretë ka kërkuar nga ana e gjykatës që me rastin e vendosjes ti vlerësoj të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe të vendos në mënyrë meritore sa i përket kërkesëpadi së paditësit.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës .

I autorizuari i të paditurës H.A, av.F.R, në fjalën e tij ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke shtuar se është vërtetuar fakti se pasardhësi i paditësit me paraardhësin e të paditurës tani të ndjerin S.S, kanë lidhur marrëveshje gojore me të cilën ia ka shitur pronën kontestuese, për të cilën pronë ka rezultuar se të paditurit me paditësin asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje, dhe të njëjtit e kanë shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe të pa penguar nga askush.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që me rastin e vendosjes ti vlerësoj të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe të vendos në mënyrë meritore sa i përket kërkesëpadi së paditësit.

Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e tyre me si vijon: U lexua certifikata e vdekjes për të ndjeri S.S me nr. rend,. 127 dt.23.04.2018, Aktvendimi i trashëgimisë nr. LRP.n.r 8836/18 dt.09.07.2018 për shqyrtimin e pasurisë së të ndjerit S.M, Autorizimi së bashku me deklaratën trashëgimore

dhënë nga R.S vetëtuar tek noteri S.SH nr. LRP.nr. 7010/19 dt.22.05.2019, Autorizimi së bashku me deklaratën trashëgimore dhënë nga XH.V vërtetuar tek noteri S.SH nr. LRP.nr. 7009/2019 dt.22.05.2019, Autorizimi së bashku me deklaratë trashëgimore dhënë nga H.B vërtetuar tek noteri S.SH nr. LRP.nr. 7007/2019 dt.22.05.2019, Procesverbali i datës 23.05.2019 në të cilën është lejuar precizimi subjektiv i padisë duke u bazuar në deklaratën e të padituri N.S, Autorizimi i të paditurës H.A dhënë avokatit F.R dt.15.10.2019, dorëzuar me anë të parashtrësës s datës 04.12.2019, Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të gjeodezisë E.K dt.16.12.2019, Fleta poseduese e datës 13.12.2019 lëshuar në emër të S.S për NK 00... ZK ...,

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se prindi i paditësit S.M me paraardhësin e të paditurve S.S kanë lidhur marrëveshje gojore për shitblerjen e paluajtshmërisë të përshkruar sikurse në pikë II të dispozitivit në vitin 1960, ku sipas kësaj marrëveshje rezulton se i ndjeri paraardhësi i paditësit e ka përmbushur në tërësi çmimin kontraktues të cilin çmim e ka pranuar i ndjeri S.S dhe ia ka dorëzuar në posedim paluajtshmërinë kontestuese respektivisht në këtë periudhë i ndjeri S.M ka hyrë në posedim të qet, të ligjshëm dhe me mirëbesim të cilin posedim e ka pasur në mënyrë të pa ndërprerje dhe pa u penguar nga askush, ku dhe pas vdekjes së tij ia ka bartur në mënyrë origjinare paraardhësit të tij tani paditësit i cili mbi bazën e parashkrimit fitues paditësit si pasardhës të ndjerit A.M paditësi e kanë fituar të drejtën e pronësisë.

Gjykata përmes aktvendimit për trashëgimi LRP.nr.8836/2018 nr. Ref.3046/2018 i datës 09.07.2018, ka vërtetuar faktin se i ndjeri pos paditësi ka lënë edhe trashëgimtar tjerë ligjor siç janë R.S, XH.V dhe H.B, të cilët përmes deklaratave trashëgimore të cilat janë administruara si provë, të njëjtit kanë hequr dorë nga e drejta e drejta e pronësisë sipas të drejtës së trashëgimisë për pjesën ideale që do tu kishte takuar atyre në pronën kontestuese respektivisht pjesët e tyre secila ia kanë ceduar paditësit.

Gjykata përmes certifikatës së vdekjes për të ndjeri S.S me nr. rend,. 127 dt.23.04.2018, ka kuptuar faktin se i njëjti ka vdekur më datën 15.03.2005, kurse përmes deklaratës të dhënë nga të paditurit N... dhe G.S në seancën e datës 23.05.2019, ka vërtetuar faktin se i ndjeri S.S pas vetës ka lënë të paditësit e parë N.S, M.S i cili ka vdekur kurse pas vetës ka lënë fëmijët A.S e

cila tani është me adresë të panjohur në Slloveni, K.S i cili ka vdekur dhe pas vetës ka lënë të paditurit G..., B..., D.S, vajzën H.S, S.S e cila ka vdekur e cila pas vetës ka lënë fëmijë tani të paditurit Z..., A... dhe I.B

Gjykata me nxjerrjen e provës përmes daljes në vendin kontestues së bashku me ekspertin e gjeodezisë E.K në ekspertizën e përpiluar dt.16.12.2019, shihet se prona kontestuese NK.nr.... në sipërfaqe prej 12.469 m² me kulturë arë e klasit të 5-të, e cila gjendet në vendin e quajtur "K.Z" Zona Kadastrale ..., evidentohet në emër të S.S i cili fakt vërtetohet përmes fletës poseduese dhe e njëjta kufizohet në anën veriore me NK.nr. 186-6 me pronar N.M dhe N.A me nga ½ e pjesës ideale si dhe me NK.nr. 187-0, me pronar J.SH, nga lindja me NK.nr.179-0 pronar juridik SH.J, me 2/3 e pjesës ideale dhe SH.SH me 1/3 e pjesës ideale, nga jugu kufizohet me NK.nr.172-0 me pronar SH.E nga perëndimi kufizohet me NK.nr.... pronar Buzhala Fadil, me NK.nr.... pronar J.SH, me NK.nr.... me pronar V.F, me NK.nr.... me pronar B.G me me NK.nr.... me pronar M.N dhe me NK.nr.... me pronar K.K.

Gjykata përmes dëgjimit të paditurve N... dhe G.S përmes deklaratave të tyre ka vërtetuar faktin se prindi i të paditurit të parë N.S, S.S këtë pronë ia kishte shitur prindërit të paditësit në vitin 1960, sipas marrëveshjes gojore dhe tani i ndjeri S.S e kishte pranuar çmimin e shitblerjes nga paraardhësi i paditësit, si dhe ka vërtetuar fakti se as paraardhësi i paditësit dhe as tani paditësi asnjëherë nuk kanë pasur asnjëherë pengesë nga tani i nderi S.S dhe e as nga trashëgimtarët e tij ligjor në shfrytëzimin e qetë të pronës kontestuese.

Gjykata përmes dëgjimit të dëshmitarit XH.Q ka vërtetuar faktin se dëshmitari me paditësin kanë raporte familjare- kushërinj, i cili ka deklaruar se pronën kontestuese paraardhësi i paditësit tani paditësi bashkë me familjen e tij e kanë shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe të pa penguar nga askush, duke shtuar se këtë rrethanë e din meqenëse me paditësin janë mexhanik dhe është në dijeni se kjo pronë është e paditësit, si dhe gjykata ka vërtetuar përmes këtij dëshmitari se i padituri parë N.S është djali i të ndjerit S.S, këtë rrethanë e ka vërtetuar për shkak se në bazë të deklaratës së të paditurit të parë N.S është lejuar edhe precizimi subjektiv i padisë pasi që i padituri i parë përveç certifikatës së vdekjes për të ndjerin S.S nuk e ka sjell edhe dëshmi vdekjen e tij përmes të cilës do të vërtetoheshin të gjithë trashëgimtarët ligjor, por arsyeja se përse i padituri i parë nuk e ka sjellë dëshmi vdekjen e tij, kjo nuk nënkupton se paditësi mos ti realizoj të drejtat e tij edhe në bazë të deklaratës së të paditurit të parë, sa i përket precizimit të padisë.

Kurse gjykata përmes dëshmitarit R.R ka vërtetuar gjendjen faktike se i njëjti rrethanën e shitblerjes e ka kuptuar nga prindi i tij, dhe nga ajo periudhë e mbanë mend se paraardhësi i paditësit, dhe pas vdekjes së tij paditësi, këtë pronë e ka shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe të pa penguar nga askush, i cili përveç kësaj ka deklaruar se paditësi këtë pronë gjithmonë e kanë shfrytëzuar- mbjellë me kulturë bujqësore dhe sikurse bashkëfshatarët tjerë edhe ai kanë shkuar dhe u kanë ndihmuar në kohën e mbjelljes, andaj gjykata duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, e veçanërisht atë të paditurit N... dhe G.S, të cilët kanë deklaruar se pasardhësi i tyre ia ka shitur pronën paraardhësit të paditësit, të njëjtat përputhet me konstatimin e gjendjes faktike, dhe nuk janë në kundërshtim me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, andaj gjykata ua ka falur besimin dëshmisë së dëshmitarëve si objektive, pasi që të njëjta përputhen edhe me ekspertizën e gjeodezisë dhe konstatimit të gjendjes faktike dhe si të tilla nuk janë edhe në kundërshtim edhe me vetë deklaratat e të paditurve N... dhe G.S.

Andaj në rastin konkretë gjykata konsideron se pretendimet e paditësit se fillimisht arsyeja e mos bartjes së pronësisë ka qenë për shkak neglizhencës për rregullimin e dokumentacionit, kurse pas vdekjes së tani të ndjerit S.S ka qenë për shkak se të paditurit nuk kanë mundur të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e trashëgimisë pasi që disa nga të paditurit janë jashtë vendit siç është e paditura A.S e cila është vajza e të ndjerit M... dhe e cila është me adresë të panjohur andaj këto pretendime përputhen në tërësi njëra me tjetrën dhe pretendimet e paditësit në lidhje me arsyet e mos bartjes së pronësisë në emër të tij janë të bazuar dhe përputhet në tërësi me provat e lart cekura.

Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se nga provat të cilat janë administruara është vërtetuar ligjshmërinë e posedimit dhe mirëbesimin dhe janë krijuar kushtet ligjore që në kuptim të nenit 28 par.4 të LTHMPJ, që paditësit t'i njihet e drejta e pronësisë në pronën e përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit sipas të drejtës së trashëgimisë duke u bazuar edhe në nenin 12 të Ligjit për Trashëgimi meqenëse është vërtetuar se pronën kontestuese e ka blerë prindi i paditësit S.M, kurse paditësi është trashëgimtar ligjor i rendit të parë të tij pasi që trashëgimtarët tjerë me anë të deklaratave trashëgimore ia kanë bartur-ceduar të drejtën e pronësisë paditësit.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës ka vendosur kuptim nenit 452 të LPK-së ka obliguar paditësin që përfaqësuesit të përkohshëm av.I.Q t'ia paguaj shpenzimet e procedurës

në shumë të përgjithshme prej 509€ dhe atë për përgjigje në padi 104€ dhe për tri seanca të mbajtura nga 135€.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.999/19 me datë 03.02.2020

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.